



Federata e Sindikatave të Shëndetësorëve të Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosovo
Sindikata Federacione Shëndetësore Kosovë

Prishtinë, 01 korrik 2020

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Odat e Profesionistëve Shëndetësor në bashkë-koordinim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësorisë së Kosovës (FSSHK), si organizata që përfaqësojnë interesat profesionale dhe socio-ekonomike të profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të përfaqësuesve, të mbajtur me 01 korrik 2020, në nivel të kryetarëve, kanë analizuar njoftimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, dhe duke i marrë në konsideratë dhe me shqetësim pozitën, rëndësinë dhe funksionin publik të profesionistëve shëndetësor, i adresojnë kërkesat e tyre të përbashkëta tek Qeveria e Republikës së Kosovës, si në vijim:

- Të gjithë profesionistëve shëndetësor t'i komepnsohet shtesa mbi pagat aktuale në shumë të referuar sipas katalogut të pagave që ishte i përfshirë në Ligjin e shfuqizuar për pagat e sektorit publik, ndërkaq dieferencat për kategori të veçanta të profesionistëve shëndetësor të diskutohen në afat prej dy javëve të ardhshme. Kjo pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka konstatuar ndonjë parregullësi dhe as shkelje kushtetuese sa i përket pjesës së rregullimit të nivelit të pagave të profesionistëve shëndetësor. Kjo pagesë shtesë të përfshihet në rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës në procedurat e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020. Pagesat shtesë të jenë të përfshira dhe të zbatueshme deri në miratimin dhe zbatimin e Ligjit të miratuar për Pagat në Sektorin Publik; dhe
- Të iniciohen të gjitha procedurat legislative në mënyrë urgjente me qëllim të procedimit të Ligjit të ri për Pagat në Sektorin Publik, dhe që procedurat e tilla, përfshirë miratimin e të njëjtit në të dy leximet në procedurë parlamentare të përfundojë deri me datë 1 tetor 2020, kështu që të krijohet mundësia që pagat e parapara me Ligjin e ri për Pagat në Sektorin Publik të jenë të përfshira në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Organizatat nënshkruese të kësaj komunikate për media, presin nga institucionet përgjegjëse se të njëjtat do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim që të mënjanohet gjendja e vështirë e profesionistëve shëndetësor, aq më shumë edhe pas zvarritjes që është bërë me rastin e shqyrtimit kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese dhe pritjet legjitime që kanë pasur profesionistët shëndetësor gjatë gjithë kësaj kohe.

Organizatat nënshkruese janë plotësisht të vetëdijshme për gjendjen emergjente në shëndetësi si pasojë e pandemisë COVID-19, andaj dhe shprehin bindjen se nuk do të jenë të detyrueshme që të ndërmarrin masat të tjera legjitime dhe të ligjshme për tu zbatuar kërkesat e tilla që janë të domosdoshme, sidomos në aktualitetin dhe dëshminë notore të kontributit të jashtëzakonshëm të profesionistëve shëndetësor për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe me këtë rast, Odat e Profesionistëve Shëndetësor do të përkrahin dhe do të ndihmojnë brenda autorizimeve të veta ligjore, çdo veprim sindikal nga FSSHK-ja, lidhur me procesin e ngritjes së pagave të të gjithë profesionistëve shëndetësor.

Me shpresë se këto kërkesa do të zbatohen me një urgjencë nga institucionet kompetente, ne jemi të hapur për çfarëdo bashkëpunimi për të ndihmuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e mëtutjeshme të kërkesave të tilla.

Me solidaritet,

Prishtinë, 01 korrik 2020

Kryetar i OMK-së

Dr. Pleurat
Sejdiu, Mr.sci

Kryetar i OIK-ut

Ma. Bsc. Naser
Krustemi

Kryetar i OSK-së

Prof. Dr. Blerim
Kamberi

Kryetar i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi

Kryetar i OFTK-së

Ass.Msci. Feim Gashi
PT

Kryetar i FSSHK-së

Dr. Blerim Syla